



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.
DEPARTAMENTI LIGJOR DHE PROKURIMEVE
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE



Data 08.11.2022

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Studim projektim e previntivim për Ndertim Depo uji V-1000 m³”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime të ndryshme.

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,629,203 (dy milion e gjashtëqind e njëzet e nëntë mijë e dyqind e tre) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

“Studim projektim e previntivim për Ndertim Depo uji V-1000 m³”

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,629,203 (dy milion e gjashtëqind e njëzet e nëntë mijë e dyqind e tre) lekë pa TVSH.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5; në vlerën 2% të fondit limit 52,584 (pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa tvsh.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):
Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht : 788,761(shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) leke pa t.v.sh.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$2,629,203 \times 30\% = 788,761$

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 43, pika 1, pika 2 c) nën 55 pika 4, si dhe nën 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021, (Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nënit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nën 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.

9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku

kanë ushtruar apo ushtrojnë aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e maturuara për vitin 2022.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për detyrimet e maturuara për vitin 2022, sipas të dhënave të QKB-së. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e maturuara për vitin 2022 të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të

ngjashme:

a) Kontratë të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit që prokurohet, përkatesisht **525,841 (pesëqind e njëzet e pesë mijë e tetëqind e dyzet e një) leke pa t.v.sh**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1.Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga **një ent publik** për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i

përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me **sektorin privat**, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$2,629,203 \times 20\% = 525,841$$

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensën profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim **(leshuar nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit)**, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme:

- 3 a, *Projektim; objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kt*
- 3 d *Vlersimi i kapacitetit mbajtes dhe perforcimi i strukturave mbajttese prej beton-arme, murature dhe metalike*
- 5 b, *Projektim furnizim me ujë-kolektorë shkarkimi*
- 5 c *Projektim ujësjellës kanalizime urbane-rurale*
- 8 a, *Rilevime inxhinierike.*
- 8 b, *Rilevime inxhinierike kadastrale.*
- 8 c, *Sisteme GIS,*
- 9 a *Studim/Vlersim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile-ekonomike deri 5 kate.*

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Vendimin Nr. 943, datë 28.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, subjektet fizike / juridikë të huaj duhet të aplikojnë për ekuivalentimin e licencës së huaj në Republikën e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për shërbimin e kondicionimit objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 7 persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Operatori ekonomik fitues, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit , duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën Tetor 2022.

Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Tetor 2022.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.4.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencat profesionale të drejtuesve teknik, përgjegjës për zbatimin e kontratës në kategorite si më poshte shenuar:

- Drejtues teknik Inxhinier Ndërtimi-Konstruktor minimumi 1 (nje), i licensuar në kategoritë 3 a,d.
- Drejtues teknik Inxhinier Hidroteknik minimumi 1 (një), i licensuar në kategoritë 5b,c
- Drejtues teknik Inxhinier Gjeodet minimumi 1 (një), i licensuar në kategoritë 8 a,b,c
- Drejtues teknik Inxhinier Gjeolog minimumi 1 (një), i licensuar në kategoritë 9 a

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 8 te DST.

Operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues (kontratën e punës, diplomën përkatëse si dhe listëpagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit (Tetor 2022) për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

a. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1(një) Drejtues teknik Inxhinier Ndërtimi-Konstruktor. Vendosja e kriterit është vendosur për arsye se në detyrën e projektimit është kërkuar raport teknik dhe planimetri skematike (1.Raporti teknik në këtë fazë duhet të përfshijë të gjitha llogaritjet dhe simulimet përkatëse të cilat përcaktojnë vëllimin e saktësuar të depozitave. Planimetria skematike paraqet të dhënat bazë të epos lartësi, gjatësi dhe ndarjen e dhomave përkatëse) për rrjedhojë lind nevoja e 1(një) Drejtues teknik Inxhinier Ndërtimi-Konstruktor

b.Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1(një) Drejtues teknik Inxhinier Hidroteknik. Vendosja e kriterit është vendosur për arsye se në detyrën e projektimit është kërkuar përcaktimi i volumit të domosdoshëm të akumulimit për furnizimin me ujë të zonës për rrjedhojë lind nevoja e 1(një) Drejtues teknik Inxhinier Hidroteknik.

c.Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1(një) Drejtues teknik Inxhinier Gjeolog. Vendosja e kriterit është vendosur për arsye se në detyrën e projektimit është kërkuar hartimi i shpimeve të rrjedhojë lind nevoja e 1(një) Drejtues teknik Inxhinier Gjeolog.

d.Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1(një) Drejtues teknik Inxhinier Gjeodet. Vendosja e kriterit është vendosur për arsye se në detyrën e projektimit është kërkuar hartime për shpime gjeologjike në zonën e parashikuar të projektit sipas parashikimeve të ligjishtslacioneve në fuqi për rrjedhojë lind nevoja e 1(një) Drejtues teknik Inxhinier Gjeodet.

Numri i punonjësve është përlllogaritur sipas proceseve të punës të cilat janë përshkruar në specifikimet teknike.

3.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e shoqërisë së tij:

- 1 (një) Ekspert për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 8 te DST.

Operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ,të gjithë dokumentacionin provues (kontratën e punës, diplomën përkatëse) si dhe çertifikatën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

a.Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1(një) Ekspert për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Vendosija e kriterit është vendosur për arsye se në detyren e projektimit është kerkuar hartimi i nje raporti mjedisor mbi impaktin e punimeve ne mjedis per objektin ne studim për rrjedhojë lind nevoja e 1(nje) Ekspert për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

3.3.6 Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354,datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në specifikimet teknike(pjesë e DST-së) janë përcaktuar edhe arsyet e vendosjes të specifikimeve teknike.